

UDHËZIM
Nr. 7, datë 6.3.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 15.2.2023, “PËR
PËRCAKTIMIN E DIPLOMAVE UNIVERSITARE TË NJËVLERSHME,
TË NGJASHME OSE TË PËRAFËRTA ME FUSHËN/LËNDËT
E MËSIMDHËNIES NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE KRITERET PËR
HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË FORMIMIT
TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKOPEDAGOGJIKE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kreu III i udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2023, “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike”, ndryshon, si më poshtë:

**“KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Për t’u regjistruar në programin përkatës të studimit të formimit të vazhduar në fushën e psikopedagogjisë, kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar për ciklin e parë të studimeve, të vendosur për pranimet në programet e ciklit të parë, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë në fushën e mësuesisë, i cili ka qenë në fuqi në vitin akademik në të cilin këta kandidatë kanë filluar studimet e ciklit të parë “*Bachelor*”, si dhe për të gjithë kandidatët e tjerë që nuk kanë ndjekur këtë kategori programesh studimi të ciklit të parë, sipas fushave të përcaktuara në aneksin nr. 1, por duan të ndjekin programin e formimit të vazhduar.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare, zyrat vendore arsimore parauniversitare dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi